

**AKTI I THEMELIMIT**  
**I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“ESP Consulting” SH.P.K.**

Sot me datë 21.11.2022 ortaku i vetëm i shoqërisë si më poshtë;

**Ada Metani**, me shtetësi shqiptare, atësia Ibrahim, e datëlindjes 10.02.1988 mbajtëse e letërnjoftimit personal me Nr. I85210070Q, madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, lindur në Tiranë dhe banuese në adresën: Njësia Administrative nr. 2, Bulevardi “Bajram Curri”, Ndërtesa Nr. 72, Ap 50, Tiranë, Shqipëri që quhet “**Ortak**”, bazuar në vullnetin e saj të lirë dhe në përputhje me ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, themelon shoqërinë sa më poshtë vijon:

**Kreu I**  
**OBJEKTI, EMËRTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK**


**Neni 1**  
**Objekti i shoqërisë**

**1.1.** Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke u fokusuar kryesisht në:

- a) Ndërmjetësim për punësim brenda/jashtë vendit, kërkim/rekrutim dhe menaxhim i fuqisë punëtore;
- b) Konsulencë në fushën e burimeve burimeve njerëzore, zhvillimin e kapaciteteve njerëzore si dhe certifikime apo trajnime për fusha të ndryshme sipas kërkesave;
- c) Shërbime në rritjen profesionale të burimeve njerëzore apo dhënien e vlerësimeve për potencialet e tyre me profilet e punës si dhe vlerësime/zhvillime/organizime të strukturave të kompanive në kuadër të rritjes së efektivitetit dhe produktivitetit;
- d) Shërbime të ndryshme, si hartim planesh biznesi, konsulenca në fushën administrative, juridike, vlerësime të procedurave operacionale të biznesit, apo tjetër.;

**1.2.** Për përmbushjen e objektit të saj shoqëria:

- a) Mund të zotërojë në mënyrë të drejtpërdrejt apo të tërthortë pjesëmarrje në shoqëri apo ndërmarrje të tjera, shqiptare apo të huaja, të cilat kanë objekt të njëjtë, të ngjashëm apo ndihmës me të. Pjesëmarrja në shoqëri që për llojin e tyre nuk ofrojnë përgjegjësi të kufizuar, miratohet paraprakisht nga Asambleja e Ortakëve;

  
1

- b) Mund të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme ose të dobishme ose që kanë të bëjnë, përfshirë por pa u kufizuar në: Ndërmjetësim për punësim, rekrutime, kërkime kandidatë potencial për punësim, trajnime suporti (hartim CV, BIO, Prezantim Intervistë), trajnime shitje, trajnime lidershipi, trajnim këshillim biznesi, vlerësim potencialesh burime njerëzore, vlerësim procese pune, plan biznesi, apo tjetër.

## **Neni 2**

### **Emërtimi dhe Selia juridike e Shoqërisë**

- 2.1.** Ortaku i vetëm vendosi që shoqërinë të emërtojë **“ESP Consulting” SH.P.K.**
- 2.2.** Selia e shoqërisë është e vendosur në Tiranë, në adresën: Njësia Administrative nr. 10, Rruga “Kajo Karafili”, H.24, Kati nr.7, Ap. nr.39, Tiranë, Shqipëri.
- 2.3.** Gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj, Shoqëria mund të hapë degë dhe zyra përfaqësimi e agjenci kudo në territorin e Republikës së Shqipërisë ose jashtë tij.

## **Neni.3**

### **Regjimi Juridik**

- 3.1.** Shoqëria është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit, dhe legjislacionit në fuqi në Shqipëri.
- 3.2.** Me vendim të tij Ortaku i vetëm mund të ndryshojë regjimin juridik të Shoqërisë, nëse në të ardhmen krijohen premisa më të favorshme për funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Në këtë rast Ortaku do të pershtasë Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqërisë, si dhe do të bëjë regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar në organet kompetente shqiptare.
- 3.3.** Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe në përputhje me ligjin.
- 3.4.** Shoqëria do të ketë vulën e saj.

## **Kreu II**

### **TË DREJTAT DHE DETYRAT, KOHËZGJATJA**

## **Neni 4**

### **Të drejtat e Shoqërisë dhe të Ortakut**

- 4.1.** Shoqëria ka të drejtë të lidhë marrëveshje dhe të nënshkruajë kontrata në territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj.



- 4.2. Shoqëria gëzon të drejtën të krijojë pasuri materiale dhe intelektuale.
- 4.3. Shoqëria ka të drejtë të marrë pjesë si ortakë në shoqëri ose ndërmarrje të ndryshme në Shqipëri ose jashtë saj, në përputhje me legjislacionin Shqiptar.
- 4.4. Shoqëria përgjigjet ndaj të tretëve vetëm dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqëror të derdhur dhe me të mirat e pasurisë së saj. Ajo në asnjë rast nuk përgjigjet për detyrimet e ortakut dhe as ky i fundit nuk mban përgjegjësi personale për detyrimet që merr përsipër shoqëria.
- 4.5. Ortaku ka të drejtë të marrë të gjitha informatat që kanë të bëjnë me veprimtarinë prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare të Shoqërisë, si bilancet, llogaritë ekonomike, apo tjetër.
- 4.6. Ortaku përballon humbjet e shoqërisë vetëm dhe deri në kufirin e vlerës së kontributeve të tij në kapitalin themeltar.

#### **Neni 5**

#### **Kohëzgjatja**

- 5.1. Kohëzgjatja e Shoqërisë është me afat të pacaktuar

#### **Kreu III**

### **KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT**

#### **Neni 6**

#### **Kapitali i Shoqërisë**

- 6.1. Kapitali themeltar është 100.000 (njqind mijë) lekë dhe është i ndarë në 1 kuotë.
- 6.2. Ndarja e pjesëve në kapitalin themeltar është: 1 kuote, përkatësisht 100% të kuotave.
- 6.3. Kapitali i shoqërisë mund të shtohet ose të pakësohet sipas vendimeve që do të marrë ortakut i vetëm.
- 6.4. Ky kapital nuk mund të jetë më i vogël se minimumi i përcaktuar me ligj.

#### **Neni 7**

#### **Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar**

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme kundrejt të tretëve.




**Kreu IV**  
**DREJTIMI DHE ORGANET KRYESORE**

**Neni 8**  
**Organet kryesore të shoqërisë**

- 8.1.** Shoqëria fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 8.2.** Emërtimi i shoqërisë tregtare, kapitali themeltar, NIPT-i duhet të jenë të përmendura në të gjitha aktet dhe dokumentat që nxjerr kjo shoqëri dhe ju drejtohen të tretëve.
- 8.3.** Organet kryesore të shoqërisë janë: Asambleja e Përgjithshme e përbërë nga ortaku i vetëm dhe Administratori.

**Neni 9**  
**Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë**

- 9.1.** Asambleja e përgjithshme përbëhet nga ortaku i vetëm i shoqërisë që është organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë dhe vendimet e tij janë të detyrueshme.
- 9.2.** Të drejtat dhe detyrime e asmblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm.
- 9.3.** Të drejtën e thirrjes së Asamblesë e kanë Administratori, eksperti kontabël i autorizuar ose ortaku i vetëm i shoqërisë. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike.
- 9.4.** Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës, jo më vonë se shtatë ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- 9.5.** Mbledhjet e asamblesë pasqyrohen në procesverbalin që mbahet me këtë rast, ndërsa vendimet nënshkruhen nga ortaku i vetëm.
- 9.6.** Procesverbalet dhe vendimet e mbledhjeve ruhen në selinë e shoqërisë.
- 9.7.** Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.
- 9.8.** Ortaku i vetëm i shoqërisë ka të drejtë ndër të tjera të marrë vendime për çështjet e mëposhtme:
- a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë.


  
4

- b) Ndryshimet e statutit.
- c) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve.
- ç) Emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar.
- d) Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike.
- dh) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
- e) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
- ë) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit.
- f) Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- g) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve.
- gj) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- h) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.
- i) Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

## **Kreu V ADMINISTRIMI**

### **Neni 10 Administrimi i Shoqërisë**

- 10.1. Shoqëria do të administrohet nga 1 (një) administrator i vetëm, i cili mund të zgjidhet edhe jashtë ortakëve të shoqërisë;
- 10.2. Administratori emërohet dhe shkarkohet nga ortaku i vetëm;
- 10.3. Administrimi i shoqërisë do bëhet nga Administratori Zj. Ada Metani me shtetësi shqiptare, atësia Ibrahim, e datëlindjes 10.02.1988 mbajtëse e letërnjoftimit personal me Nr. I85210070Q, madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.
- 10.4. Kohëzgjatja në detyrë e administratorit të shoqërisë do të jetë 5 (pesë) vjet me të drejtë ripërtëritje në përfundim të mandatit;
- 10.5. Administratori i vetëm i ka të gjitha të drejtat dhe fuqitë për drejtimin e zakonshëm të shoqërisë, me qëllim arritjen e objektivave të saj;
- 10.6. Administratorit i takon firma/nënshkrimi i lirë dhe përfaqësimi i shoqërisë ndaj të tretëve në veprime, procedura dhe seanca gjyqësore, arbitrazhi ose administrative;
- 10.7. Administratori është përgjegjës, sipas rastit, ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të Statutit apo dëme të kryera gjatë ushtrimit të detyrës;
- 10.8. Kompetencat e administratorit në mënyrë konkrete dhe të detajuar përcaktohen në aktin e emërimit;
- 10.9. Administratori përveç të tjerave ka të drejtë dhe detyrohet:
  - a) të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

 5

- b) të përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) të përgatis dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) të kryejë regjistrimet dhe të dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- g) raporton përpara ortakut të vetëm në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) të kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut;
- i) administrimin e pasurisë së Shoqërisë, duke përfshirë mjetet financiare, brenda caqeve të lejuara nga ortakut i vetëm;
- j) kryerjen e të gjitha veprimeve bankare në interes të shoqërisë;
- k) të përfaqësojë Shoqërinë me të tretet në të gjithë veprimtarinë e saj dhe të mbrojë interesat e saj në gjykatë apo arbitrazh, nënshkrimin e kontratave në emër të shoqërisë dhe ndjekjen e zbatimit të tyre;
- l) t'i propozojë ortakut të vetëm për miratim strukturën e aparatit të Shoqërisë dhe krijimin e organeve të tjera të domosdoshme për realizimin e objektivave të Shoqërisë;
- m) t'i propozojë ortakut të vetëm për miratim numrin e punonjësve të Shoqërisë, pagat dhe emërimin e shkarkimin e tyre.


## Kreu VI

### VITI FINANCIAR, LLOGARITË VJETORE, NDARJA E FITIMEVE

#### Neni 11

#### Veprimtaria e Shoqërisë

11.1. Çdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përgjithësisht viti i parë, i cili fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit.



6

11.2. Llogaritë vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit financiar, raportet e veçanta të hartuara nga administratori dhe eventalisht eksperti kontabël i autorizuar, miratohen nga Ortaku i vetëm.

11.3. Miratimi i dokumenteve mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda 3 muajve nga mbyllja e vitit financiar.

## Neni 12

### Kontrolli i Shoqërisë

12.1. Kontrolli i Shoqërisë kryhet nga nje Ekspert Kontabël i Autorizuar, i emëruar nga ortaku i vetëm.

12.2. Eksperti kontabël i autorizuar garanton që llogaritë vjetore të shoqërisë janë të rregullta dhe pasqyrojnë rezultatet e vitit të kaluar financiar, si dhe gjendjen financiare të shoqërisë. Ai verifikon librat e llogarive, si dhe fondet e shoqërisë, kontrollon përshtatjen e kontabilitetit me ligjin në fuqi, verifikon përputhjen me llogaritë vjetore të informacionit në raportin e administrimit, kontrollon gjithë librat e llogarisë, dokumentat kontabël dhe regjistrat e proces-verbaleve. Mund të aktivizojë ekspertë dhe bashkëpunorë për të përballuar volumin e punës, por duke marrë më parë miratimin e ortakut të vetëm.

12.3. Shkarkimi i Ekspertit kontabël të autorizuar vendoset në të njëjtat kushte si emërimi nga ana e ortakut të vetëm.

## Kreu VII

### PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË

## Neni 13


### Prishja dhe likuidimi i Shoqërisë

13.1. Shoqëria mund të prishet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak, si në rast falimentimi, privim të të drejtave për të ushtruar aktivitetet tregtar, forca madhore dhe faktorë të tjerë që nuk varen nga Ortaku.

13.2. Shoqëria hyn në fazën e likuidimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi, ortaku i vetëm emëron një ose disa likuidatorë, të cilët i paraqesin atij raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likuidimit dhe afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre.

13.3. Në fund të procesit të likuidimit, ortaku i vetëm vendos mbi bilancin përfundimtar financiar, mbi aktin e rregullshmërisë së punës së likuiduesit, dhe mbylljen e procesit të likuidimit.

13.4. Pas pagimit të kreditorëve dhe shlyerjes së pjesëve të kapitalit themeltar tek kontribuesit përkatës, likuidatori ndan kapitalet e mbetura për ortakun e vetëm të shoqërisë.



**Neni 14**  
**Zgjidhja e mosmarrvëshjeve**

14.1. Mosmarrëveshjet midis ortakëve, shoqërisë dhe të tretëve në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**Kreu VIII**  
**DISPOZITA TE FUNDIT**

**Neni 15**


15.1. Për sa nuk është e parashikuar në këtë Akt, do t'i behet referim ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, si dhe legjislacionit përkatës në fuqi.

15.2. Akti i Themelimit hartohet në 3 (tre) kopje, secila me të njëjtën vlerë ligjore. Njëra prej kopjeve ruhet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

15.3. Ngarkohet Administratori, për regjistrimin dhe kryerjen e të gjitha veprimeve të nevojshme për regjistrimin e Shoqërisë pranë Q.K.B-së.

**ORTAKU I VETEM I SHOQËRISË**

Emër, mbiemër, nënshkrim

Abe Metani 

Tiranë më : 21/11/2022